

URDHËR
Nr.168/2, datë 18.3.2020

PËR KUFIZIMIN E LËVIZJES ME AUTOMJETET PRIVATE OSE
SHTETËRORE TË ADMINISTRATËS PUBLIKE

Në mbështetje, të nenit 7, pika 4, gërmat “d” të ligjit nr.15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, sipas udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e lëvizjes me automjetet private ose automjete shtetërore të punonjësve të administratës publike të institucioneve qendrore dhe atyre vendore, puna e të cilëve lidhet me qëndrimin në zyrë dhe jo në terren.

2. Përjashtim nga ky rregull bëjnë punonjësit e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale përfshirë personelin mjekësor dhe infermjeror, punonjësit e Ministrisë së Mbrojtjes, Ministrisë së Financës apo të prefekturave dhe bashkive që janë të përfshirë në listën prioritare të firmosur nga titullari i institucionit.

3. Ministrinë dhe institucionet e administratës publike që nuk janë të përfshira në pikën 2 të këtij urdhri të paraqesin kërkesë pranë autoriteteve kompetente për personelin e tyre që duhet të lëvizë me automjet privat ose shtetëror, për t’u pajisur me lejë të posaçme.

4. Titullarët e institucioneve të vartësisë të institucioneve të përcaktuar në pikën 2 të këtij urdhëri të dërgojnë pranë ministrit ose kryetarit të bashkisë listën e arsyetuar të personave që duhet të lëvizin me automjetin privat ose shtetëror. Lista me emrat i përcillet autoriteteve kompetente për tu pajisur me leje të posaçme.

5. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri titullarët e institucioneve qendrore dhe vendore të përfshira në këtë urdhër.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu